

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMEVE

(FONDI I KOMPENSIMIT)

BULETININFORMATIV

II

Prishtinë, Mars 2017

Përmbajtja:

1. Historiku i Fondit të Kompensimit, ish Fondi i Garancisë së Kosovës
2. Statusi Ligjor dhe Struktura organizative-funksionale e Byrosë Kosovare të Sigurimeve – Fondit të Kompensimit
3. Financimi i Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve
4. Procedurat e paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit pranë - Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve
5. E drejta ligjore e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve në rimbursimin e mjeteve financiar për dëmin e paguar
6. Numri i dëmeve të paguara nga Fondi i Kompensimit
7. Numri i dëmeve të paraqitura dhe të rezervuara nga Fondi i Kompensimit
8. Struktura e dëmeve të paraqitura në Byronë Kosovare të Sigurimeve - Fondin e Kompensimit
 - a. Statistikat në përqindje bazuar në aspektin administrativ-Komunat të organizimit administrativ të Republikës së Kosovës
 - b. Dëmet nga automjetet me Targa nga Republika e Serbisë dhe e Malit të Zi
 - c. Dëmet e shkaktuara nga shkaktaret e paidentifikuar NN, trajtimi dhe pagesa e tyre.
 - d. Dëmet nga makineritë bujqësore traktorët
 - e. Dëmet e shkaktuara nga veturat, kamionët (të gjitha kategoritë përveç kategorisë nën b,c,d)
 - f. Pjesëmarrja e kategorive të dëmeve të lartë përshkruara në totalin e dëmeve në Fondin e Kompensimit
9. Efekti i kostos së Dëmeve të Fondit të Kompensimit – BKS në zhvillimin e Industrisë së Sigurimeve
10. Infrastruktura ligjore në Republikën e Kosovës lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve
 - efektet e vendimet ligjore të organeve Shtetërore të Republikës së Kosovës në ngritjen e numrit të dëmeve nga automjetet e pasiguruara
11. Praktikak ligjore të vendeve të zhvilluara, aplikimi i të cilave ka rezultuar me zvogëlimin e numrit të automjeteve të pasiguar

1. Historiku i Fondit të Kompensimit ish Fondi i Garancisë së Kosovës

Fondi i Garancisë së Kosovës është themeluar me dispozitat e Rregullores Nr. 1999/22 si akt ligjor i Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe nenit 4 të Rregullit 3 të datës 22.01.2003 bazuar mbi ndryshmin e Rregullit 3 për sigurimin e TPL-mjeteve motorike të datës 27.06.2002 i nxjerrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (e quajtur BPK). Në statutin e Fondit të Garancisë si akt juridik më i lartë i brendshëm i Fondit të Garancisë, themelues të Fondit të Garancisë janë Kompanitë e Sigurimeve të licencuara në Republikën e Kosovës për shitjen e sigurimit të Auto përgjegjësisë-TPL.

Baza ligjore e funksionimit të ish Fondit të Garancisë ka qenë Rregulli 3 i cili ka qenë në fuqi deri me hyrjen në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në të cilin Rregull në nenin 4 dhe 5 përshkruhen obligimet dhe të drejtat e Fondit të Garancisë si entitet ligjor. Fondi i Garancisë si entitet ligjor është subjekt juridik me të drejta të plota të përshkruar në Rregullin 3 dhe në Statutin e ish Fondit të Garancisë dhe komfor këtyre akteve ka autorizime të plota ligjore për tu paraqitur si subjekt juridik në qarkullimin juridik për realizimin e të drejtave të veta dhe për të qenë i kërkuar respektivisht i paditur për përmbushjen e obligimeve që kanë palët e drejta e të cilave buron nga Rregulli 3.

Themelues të Fondit të Garancisë së Kosovës janë Kompanitë e Sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për shitjen e sigurimeve të Auto përgjegjësia. Themelimi i Fondit ishte i rregulluar në nenin 4 pika 4.2 të Rregullit 3 deri në miratimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

2. Statusi ligjor dhe struktura organizative – funksionale e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve

a) Fondi i Kompensimit në Byronë Kosovare të Sigurimeve është paraparë me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga auto përgjegjësia i cili është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me datë 23.06.2011 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit të të njëjtit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji konkretisht në Nenin 43 të tij ku janë përshkruar dispozitat kalimtare është përcaktuar edhe shfuqizimi i çdo dispozite të rregullores së UNMIKUT 2001/25 mbi bazën e së cilës ka funksionuar ish Fondi i Garancisë së Kosovës, kur janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Praktikisht Fondi i Kompensimit i themeluar me Ligj edhe me tutje funksionon mbi principe të njëjta që ka funksionuar edhe Fondi i Garancisë së Kosovës, dhe është pasardhës juridik i Fondit të Garancisë së Kosovës, ku edhe ka trashëguar kontestet nga ish Fondi i Garancisë së Kosovës.

Në Kreun 3 (tre) të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ku janë përcaktuar statusi, funksionimi, organizimi dhe raportimi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve, në Nenin 29 par. 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, është përcaktuar se Byroja Kosovare e Sigurimeve kryen funksionin e Fondit të Kompensimit për pagesën e dëmeve të parashikuara me këtë ligj, me mjetet nga Fondi i Kompensimit.

Fondi i Kompensimit administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë të pasiguruar, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë të paidentifikuar, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë me regjistrim të huaj dhe ju ka skaduar sigurimi kufitar, të përcaktuara më në detaje në nenet 18, 19, 20, 21, dhe 22 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar që të kontribuojnë çdo tre muaj financiarisht në Fondin e Kompensimit, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin pasardhës sipas Nenit 32 par 2 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Në po këtë Ligj përkatësisht në Nenin 32 par. 3 janë përcaktuar është burime tjera të Fondit të Kompensimit e që janë arkëtime prej rimbursimit në procedurat e regresit; kontributet shtesë të siguruesve, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat; rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët fondi i kompensimit ka paguar dëmshpërblim; të ardhurat nga investimi i mjeteve të fondit të kompensimit; burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

Para kontributit të siguruesve në Fondin e Kompensimit BQK-ja, me propozimin e Byrosë, çdo vit vendos shumën e kontribuuesve që të njëjtit duhet ta paguajnë, si dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet financimi i mjeteve.

Është e ndaluar që kërkesat nga Fondet pensioneve, invalidore, dhe shëndetësore të rimbursohen nga Fondi i Kompensimit.

Shtetasve të huaj u njihet e drejta në dëmshpërblim për dëmet që paguhet nga Fondi i Kompensimit, përveç në rastet kur kjo e drejtë nuk u njihet shtetasve Kosovar me Ligjin e shtetit të cilit i përket i dëmtuari.

Fondit i Kompensimit mbahet i veçantë në llogaritë e përcaktuara nga BQK-ja brenda territorit të Republikës së Kosovës, por është paraparë mundësia që mjetet nga Fondi i Kompensimit të mund të investohen në letra me vlerë të Qeverisë si dhe në depozita bankare.

Byroja e Sigurimeve është e obliguar që për çdo muaj të paraqes pranë BQK-së raportin e gjendjes së aktives në mbulimin e Fondit të Kompensimit, po ashtu është e obliguar që ta njoftoj BQK-në kur siguruesi vepron në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, në rast të mosrespektimit të obligimeve nga ana e Siguruesve Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm po ashtu ka paraparë edhe masat ndëshkuese deri tek revokimi i licencës për veprimtarinë e Sigurimit të Detyrueshëm.

b) Struktura organizative e Fondit të Kompensimit së Kosovës është e rregulluar me Statutin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve si akti më i lartë i brendshëm. Udhëheqja e Byrosë Kosovare të Sigurimeve - Fondit të Kompensimit – organet drejtuese të saj janë të parapara në Nenin 30 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia në të cilën përshkruhet së Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit drejtohet nga Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Administrativ, Drejtori Ekzekutiv. në mbështetje të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit ka nxjerr edhe Statutin ku në detaje përshkruhen të drejtat dhe obligimet e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive të Byrosë Kosovare të Sigurimeve – Fondit të Kompensimit. Asambleja e Përgjithshme, dhe Këshilli Administrativ komfor dispozitave të Statutit në koordinim me Drejtorin Ekzekutiv e udhëheqin aktivitetin e Fondit duke i koordinuar të gjitha përgjegjësit dhe të drejtat e të cilat në mbledhje të rregullta sipas statutit shqyrtohen dhe miratohen. Byroja Kosovare e Sigurimeve ka Drejtorin Ekzekutiv i cili zgjidhet komfor dispozitave të Statutit dhe të drejtat dhe detyrimet e Drejtorit janë gjithashtu të përshkruar në dispozita të Statutit. Byroja Kosovare e Sigurimeve më tutje ka Departamentin e Dëmeve të Fondit të Kompensimit dhe Sigurimit Kufitar në kuadër të Departamentit Juridik, Departamentin e Financave dhe Administratës, Departamentin e Sigurimit Kufitar, Departamentin Antimashtrim, Departamentin e Qendrës Informative, si dhe komisionin për trajtimin e kërkesave për kompensimin e dëmeve si organ që mblidhet varësisht prej intensitetit të kërkesave të dëmeve më së paku një herë në javë.

3. Financimi i Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve

Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar të kontribuojnë çdo tre (3) muaj financiarisht në Fondin e Kompensimit, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin paraardhës. Por në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia janë paraparë edhe burime tjera të Fondit të Kompensimit e që janë: arkëtime prej rimbursimit në procedurat e regresit; kontributet shtesë të siguruesve, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat, rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët Fondi i Kompensimit ka paguar dëmshpërblim; të ardhurat nga investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit, burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

BQK-ja në cilësi të Mbikëqyrësit të Industrisë së Sigurimeve, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Kompanive të Sigurimeve në Fondin e Kompensimit që administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, si dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet

derdhja e mjeteve, Fondi i kompensimit mbahet i veçantë në llogaritë e përcaktuara nga BQK-ja, brenda territorit të Republikës së Kosovës. Fondi i Kompensimit mund të investohet në letra me vlerë të Qeverisë dhe depozita bankare. BQK-ja si organ mbikëqyrës i Industrisë së Sigurimeve nxjerr rregulla shtesë për mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të aktives në mbulim të këtyre fondeve. Byroja i paraqet BQK-së çdo muaj raportin për gjendjen e aktivës në mbulim të Fondit të Kompensimit. Byroja është e detyruar të njoftojë menjëherë BQK-në, kur siguruesi vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji përkitazi me detyrimet e financimit të Fondit të Kompensimit. Kur siguruesi nuk ka zbatuar detyrimet e parashikuara në këtë ligj për financimin e FK, BQK-ja i revokon siguruesit licencën për veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm.

4. Procedurat e paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit pranë Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve

Për dëmet të cilat automjetet e pajegjistruara dhe të pasiguruara i shkaktojnë në trafik fillimisht bëhet një proces nga Policia e Trafikut mbi bazën e të cilit identifikohet edhe shkaktari i dëmit. Pasi të pranohet kërkesa për kompensim të dëmit në Departamentin e Dëmeve të Fondit të Kompensimit pranë Byrosë Kosovare të Sigurimeve, në afatin e paraparë ligjor sipas rregullores për procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin të dëmit të nxjerrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, komisionet për vlerësimin, trajtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat për kompensim dëmi janë të obliguar ta trajtojnë dëmin dhe të dëmtuarit t'ia kompensoj atë. Pas pagesës së dëmit, zyrtarët përkatës të Byrosë Kosovare të Sigurimeve - Fondit të kompensimit ftojnë shkaktarin e dëmit dhe e informojnë për pagesën dhe i japin mundësi që dëmin e paguar nga Fondi, shkaktari i dëmit ta kompensoj në rrugë jashtëgjyqësore duke i krijuar mundësi që lartësinë e dëmit ta paguan me këste në shuma më të vogla. Nëse shkaktari i dëmit nuk ndërmerr veprimin për të filluar të paguaj shumën e dëmit të cilin Fondi i ka paguar për fajin e tij të dëmtuarit atëherë zyrtarët e Fondit iniciojnë procedurën e regresimit të dëmit në rrugë gjyqësore.

Procedura me rastin e paraqitjes së dëmit:

1. Trajtimi i dëmeve nga sigurimi i auto përgjegjësisë bëhet nga Siguruesi, në këtë rast Byroja Kosovare e Sigurimit – Fondi i Kompensimit, ku shkaktari i dëmit është pa sigurim.
2. Siguruesit mund të lidhin marrëveshje sipas të cilës kërkesa për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të auto përgjegjësisë mund t'i parashtrahet dhe të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë.
3. Kërkesën për kompensimin e dëmit e pranon personi i autorizuar nga Siguruesi. Me rastin e pranimit të kërkesës për kompensim dëmi, personi i autorizuar ka për detyrë që ta verifikojë vlefshmërinë e mbulesës siguroese.
4. Kërkesa për kompensim bëhet në formë të shkruar nga i dëmtuari personalisht, përmes përfaqësuesit ligjor apo nga i autorizuari i tij.
5. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për kompensimin, Siguruesi është i detyruar që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për kompensim, të njoftoj me shkrim të

- dëmtuarin, përfaqësuesin ligjor apo të autorizuarin e tij, duke precizuar së me cilat prova dhe dokumentacion duhet plotësuar kërkesën e tij.
6. Kërkesa për kompensim dëmi duhet të paraqitet në zyrën qendrore apo në degët e Siguruesit në njërin nga mënyrat si më poshtë:
 - a) drejtpërdrejtë
 - b) me postë,
 - c) me postë elektronike (e-mal)
 - d) me faks,
 7. Kërkesa për kompensimin e dëmit bëhet me plotësimin e *formularit unik* “Paraqitja e kërkesës për kompensimin e dëmit nga sigurimi i auto përgjegjësish”.
 8. Nëse i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ka parashtruar kërkesën përmes postës elektronike (e-mal) ose faksit, plotësimi i formularit të përmendur në paragrafin 7 të këtij neni nuk është i nevojshëm. Në raste të tilla, Siguruesi obligohet që brenda afatit prej tri (3) ditësh ta njoftojë paraqitësin e kërkesës për kompensim dëmi që të sjellin në formë fizike dokumentacionin e nevojshëm origjinal.
 9. Kur personi i autorizuar i Siguruesit e pranon formularin mbi kërkesën e shkruar për kompensim dëmi, ai është i obliguar që:
 - a) Ta rishikoj formularin e plotësuar (Paraqitja e kërkesës për kompensimin e dëmit nga sigurimi i auto përgjegjësish), ta verifikojë rregullsinë e plotësimit, të konstatoj nëse është e qartë së kush është pjesëmarrës në aksident, nëse është dhënë përshkrimi detaj i rrjedhës së ngjarjes dhe skicimi i aksidentit si dhe nëse është i nënshkruar formulari.
Në rast së formulari i plotësuar është i pakuptueshëm ose nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara, do t’i kërkohej paraqitësit të kërkesës që ta plotësojë edhe një herë formularin.
 - b) Me nënshkrimin e formularit nga pala e dëmtuar vërtetohen të dhënat e paraqitura në kërkesën për kompensim të dëmit.
 - c) Siguruesi mund të kërkojë të caktohet vendi dhe koha e shikimit – vlerësimit të dëmit material, bashkërisht me të dëmtuarin.
 - d) Dokumentacioni për kompensim dëmi do të mbahet në dy kopje, njëra kopje mbahet nga Siguruesi, kurse kopja tjetër mbahet nga i dëmtuari apo i autorizuari i tij.
 10. Për mënyrën e kompensimit të dëmit në mjete motorike pala e dëmtuar informohet për mundësit e kompensimit si më poshtë:
 - a) Sipas marrëveshjes mes palëve, në bazë të faturave të riparimit
 - b) me firmosje të pëlqimit të palës së dëmtuar që riparimi të realizohet dhe paguhet nga siguruesi në njërin nga serviset me të cilat Siguruesi ka kontratë bashkëpunimi.

5. E drejta ligjore e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve në rimbursimin e mjeteve financiare për dëmin e paguar

Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit si entitet ligjor pas përmbushjes së obligimeve komfor Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe rregullores së BQK-së për procedurat e trajtimit të dëmeve, ka edhe të drejtën ligjore komfor nenit 3 pika 4 dhe nenit 14 pika 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm që nga shkaktari i dëmit të kërkojë rimbursimin e


mjeteve financiare të cilat i ka paguar për dëmin të cilin e ka shkaktuar personi përgjegjës i cili automjetin e ka shfrytëzuar në trafik në kundërshtim me rregullat ligjore për ta regjistruar dhe siguruar. Nga kërkesat për rimbushim si ato jashtëgjqësore por edhe ato në procedura gjyqësore shuma e regresit është në disproporcion shumë të madh dhe atë nga shumë faktor duke filluar nga gjendja materiale-pamundësia e shkaktarit të dëmit që ta marr përispër pagesën e shumës së dëmit të paguar, tej zgjatja e procedurave gjyqësore e deri të mohimi i fakteve mbi bazën e të cilave është shkaktuar aksidenti dhe llogaritja e lartësisë së dëmit.

Në tabelën në vijim janë prezantuar shuma e realizuar e rimbursimit

Byroja Kosovare e Sigurimeve ka parashtruar një numër të madh të padive të regresit ndaj personave përgjegjës shkak aksidentesh, një numër i madh i tyre është në proces gjyqësor që përfaqësohen si raste nga përfaqësuesit ligjor pranë gjykatave me qëllim realizimin me sukses të kontesteve të rimbursimit.

Shuma e rimbursuar e dëmeve deri me tani sipas viteve është si në vijim.



Viti	Shuma e rimbursuar
2012	2,266
2013	4,986
2014	14,174
2015	27,184
2016	24,456
TOTAL:	73,066



6. Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit – BKS

1). Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Garancisë - Kompensimit në fillim ka qenë numër i arsyeshëm dhe komfor parametrave të pritshme që i kanë edhe vendet me një sistem dhe infrastrukturë ligjore shumë më të përparuar se sa Republika e Kosovës. Në tabelën në vijim mund ta shihni trendin e numrit të dëmeve ndër vite duke u rritur deri në shifra shqetësuese, i cili trend ka arritur shkallën alarmuese ku si efekt mundet ta dëmtoj seriozisht Industrinë e Sigurimeve duke u bërë barrë financiare.

Viti	Numri i dëmeve	Shuma e paguar
2010	2255	3,253,561
2011	2016	3,141,632
2012	2139	3,500,529
2013	2345	3,756,892
2014	1891	2,793,903
2015	1447	3,229,362
2016	1539	3,325,345
TOTAL:	13632	23,001,224



2). Mesatarja e dëmeve të paguara në FK e paraqitur në mënyrë tabelore tregon për lëvizjen e mesatares së dëmeve të paguara sipas natyrës së dëmit të trajtuar si dhe vendit të trajtimit (dëmet në procedurë gjyqësore si dhe dëmet në procedurë jo gjyqësore). Bazuar në statistikat lidhur me lartësinë e dëmeve të trajtuara e të paguara në këto vite të zhvillimit të industrisë së sigurimeve mesatarja e një dëmi të paguar në procedurë jogjyqësore në vitin 2016 është prej 1,072 euro, ndërsa në procedure gjyqësore 8,688 euro. Duke analizuar të dhënat mund të vijmë deri konkludimi i kostos së Industrisë së Sigurimeve për të përballuar Fondin e Kompensimit duke i shtuar edhe shpenzimet tjera si rezervat, risigurimi dhe shpenzimet e administrimit të Fondit.

Në tri tabela si më poshtë janë të paraqitura dëmet e paguara dhe mesatarja të ndara në:

* Dëmet në procedurë jashtëgjyqësore.

** Dëmet në gjykata.

*** Total të paguara

* Dëmet në procedurë jashtëgjyqësore.

EMRI	VIII 2012			VIII 2013			VIII 2014			VIII 2015			VIII 2016		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	1218	995,392	817	1289	961,570	746	940	771,772	821	834	755,750	906	816	700,194	858
DËME NË PASURI TJETËR	20	16,063	803	19	9,603	505	25	13,736	549	9	3,657	406	21	10,817	515
DËME ME LËNDIM	728	1,066,369	1,465	829	1,215,178	1,466	759	1,007,659	1,328	450	655,686	1,457	477	581,721	1,220
DËME ME VDEKJE	18	306,247	17,014	9	108,921	12,102	11	139,879	12,716	5	64,971	12,994	5	121,310	24,262
TOTAL:	1984	2,384,071	1,202	2146	2,295,270	1,070	1735	1,933,046	1,114	1298	1,480,062	1,140	1319	1,414,043	1,072

** Dëmet në gjykata

EMRI	VIII 2012			VIII 2013			VIII 2014			VIII 2015			VIII 2016		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	19	82,279	4,330	23	38,854	1,689	22	70,408	3,200	20	47,171	2,359	27	38,060	1,410
DËME NË PASURI TJETËR	0	0	#DIV/0!	1	7,810	7,810	3	6,398	2,133	2	28,491	14,246	3	7,125	2,375
DËME ME LËNDIM	128	868,606	6,786	166	1,180,242	7,110	127	687,422	5,413	120	1,337,076	11,142	180	1,594,698	8,859
DËME ME VDEKJE	8	165,573	20,697	9	234,717	26,080	4	96,629	24,157	7	336,562	48,080	10	271,419	27,142
TOTAL:	155	1,116,458	7,203	199	1,461,622	7,345	156	860,857	5,518	149	1,749,300	11,740	220	1,911,302	8,688

***Total të paguara


EMRI	VIII 2012			VIII 2013			VIII 2014			VIII 2015			VIII 2016		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	1237	1,077,671	871	1312	1,000,424	763	962	842,180	875	854	802,920	940	843	738,255	876
DËME NË PASURI TJETËR	20	16,063	803	20	17,413	871	28	20,134	719	11	32,148	2,923	24	17,942	748
DËME ME LËNDIM	856	1,934,975	2,260	995	2,395,419	2,407	886	1,695,081	1,913	570	1,992,762	3,496	657	2,176,419	3,313
DËME ME VDEKJE	26	471,819	18,147	18	343,637	19,091	15	236,508	15,767	12	401,533	33,461	15	392,729	26,182
TOTAL:	2139	3,500,528	1,637	2345	3,756,892	1,602	1891	2,793,903	1,477	1447	3,229,362	2,232	1539	3,325,345	2,161

7. Numri i dëmeve të paraqitura dhe të rezervuara nga Fondi i Kompensimit – BKS

Numri i dëmeve të paraqitura në Fondin e Garancisë – Kompensimit sikurse tek dëmet e paguara në fillim ka qenë numër i arsyeshme komfor parametrave të pritshme. Në tabelën në vijim mund ta shihni trendin e numrit të dëmeve ndër vite duke u rritur deri në shifra shqetësuese viti 2013, në vitin 2014 dhe në vijim kemi rënie të rasteve të paraqitura, trend i cili vazhdon deri në 9 mujorin e vitit 2016.


- Numri i dëmeve të paraqitura sipas viteve të prezantuara në mënyrë tabelore dhe grafike.

Viti	Numri i dëmeve të paraqitura
2010	2309
2011	2564
2012	2565
2013	2647
2014	2180
2015	2128
2016	2099
TOTAL:	16492



- Shuma e rezervuar e dëmeve pezull (rezervat e dëmeve) sipas viteve:

Viti	Shuma e rezervuar në euro
2012	6,447,805
2013	7,249,125
2014	9,024,929
2015	13,070,619
2016	13,517,267



8.Struktura e dëmeve të paraqitura në Fondin e Kompensimit – BKS

a) Statistikat në numër dhe përqindje të dëmeve në varësi të Komunave ku ka ndodhur aksidenti


Në mënyrë që masat eventuale administrative dhe preventive të mund të mirren nga organet shtetërore kompetenca e të cilave është regjistrimi i automjeteve dhe implementimi i Ligjit mbi

Sigurinë në Trafik, në tabelën në vijim e kemi paraqitur numrin e aksidenteve nga automjete e paregjistruar dhe vendodhjen-Komunën ku ka ndodh aksidenti.


Qyteti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Kos	75	108	261	627	489	49	1
Deçan	70	69	36	26	38	38	46
Dragash	4	6	7	2	9	1	6
Ferizaj	99	127	137	125	117	114	135
Fushë Kosovë	44	62	104	28	25	90	87
Gjakovë	71	78	77	83	55	77	68
Gjilan	151	162	147	97	87	79	66
Glogovc	81	86	76	46	38	95	112
Graçanicë	3	2	0	0	6	14	10
Hani i Elezit	1	3	5	7	2	3	0
Istog	46	45	37	39	38	44	40
Junik	0	1	1	0	0	1	4
Kamenicë	28	29	21	12	10	20	16
Kaçanik	13	19	22	20	11	18	31
Klinë	55	43	63	46	39	59	56
Kllokot	0	0	5	7	5	2	4
Leposaviq	1	1	0	0	0	4	1
Lipjan	77	103	91	84	52	61	72
Malishevë	61	81	70	72	48	85	53
Mamusha	0	0	0	3	0	3	1
Mitrovicë e Jugut	89	93	92	93	82	76	86
Mitrovicë e Veriut	0	0	0	0	0	2	3
Novobërdë	0	4	2	0	1	5	2
Obiliq	36	25	17	38	28	23	30
Partesh	0	0	0	4	0	2	1
Pejë	173	206	194	203	185	176	144
Podujevë	232	206	164	145	144	182	174
Prishtinë	519	570	465	416	336	412	397
Prizren	108	122	146	147	83	122	120
Rahovec	37	49	54	40	34	32	29
Ranilluk	0	0	0	0	0	0	2
Shtime	26	26	18	22	28	25	29
Shtërpce	2	5	3	21	2	8	5
Skenderaj	63	58	60	41	38	31	51
Suharekë	52	59	77	60	51	54	78
Viti	23	45	27	28	39	40	36
Vushtrri	67	68	84	62	58	79	100
Zubin Potok	0	1	0	0	0	0	0
Zveçan	2	2	2	3	2	2	3
TOTAL:	2309	2564	2565	2647	2180	2128	2099

Pasqyra në mënyrë grafike sipas qyteteve e shprehur në përqindje për vitet 2010-2016


Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2010




Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2011




Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2012




Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2013




Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2014



Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2015



Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitit 2016



Nga numri dhe përqindjet që janë detajuar më lartë mund të shihet së qyteti i Prishtinës fatkeqësisht në çdo vit avancohet me numrin më të madh të aksidenteve nga automjetet të cilat nuk regjistrohen dhe as nuk sigurohen.

b) Dëmet nga automjetet me targa nga Republika e Serbisë dhe Malit të Zi

Deri me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së mirëkuptimi ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Shtetit të Serbisë për sa i përket çështjes së sigurimeve, Industria e Sigurimeve ka bartur një barrë të padrejtë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga automjetet me sigurim të kompanive të sigurimeve të shtetit Serb për faktin se në një periudhë të gjatë kohore për arsye të ndryshme të njëjtat automjete nuk iu kanë nënshtruar pagesës së sigurimit kufitar. Gjithashtu të njëjtën barrë e ka paguar edhe për sa i përket automjeteve të siguruara nga kompanitë e sigurimeve të shtetit të Malit të Zi për arsye se të njëjtat po ashtu nuk iu kanë nënshtruar sigurimit të detyrueshëm kufitar, këto automjete të cilat pa sigurim kanë qarkulluar nëpër rrugët e Kosovës shkaktojnë dëme të cilat Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit të Kosovës i mbulon si dëme të shkaktuar nga automjete të pasiguruara.

Për të dhënë një pasqyrë të kostos të cilën Industria e Sigurimeve në Kosove e ka bartur deri me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së mirëkuptimit me shtetin e Serbisë për sa i përket çështjes së sigurimeve, në tabelat me poshtë janë pasqyruar dëmet e shkaktuara nga veturat me tabela Serbi dhe Mali i Zi nga viti 2010 deri 2016.

ME TABELA - SERBI	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dëmeve të paraqitura	139	218	86	99	32	22	3
Numri i dëmeve të paguara	154	175	109	91	44	21	8
Shuma e paguar	164,718	207,735	234,759	161,700	63,811	39,683	8,882

ME TABELA - MALI I ZI	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dëmeve të paraqitura	49	49	18	16	3	9	4
Numri i dëmeve të paguara	62	35	26	18	9	7	8
Shuma e paguar	92,935	65,948	50,395	61,536	33,616	11,974	9,422

c) Dëmet e shkaktuar nga automjetet-shkaktarët e paidentifikuara - dëmet NN

Dëmet NN konsiderohen dëmet të cilat personi i cili ka pësuar dëm në trafik nga automjeti i cili pasi që ka shkaktuar dëmin në lëvizje nuk është ndalur dhe nuk është identifikuar as nga personi i dëmtuar as nga organet e Shtetit- Policia. Pas verifikimit dhe konstatimit të dëmit nga zyrtarët e Fondit të Kompensimit natyrisht bazuar në kërkesën për kompensim të dëmit nga personi i dëmtuar, Fondi bën edhe pagesën e dëmit në lartësinë e caktuar nga komisioni i trajtimit të dëmeve në kuadër të Fondit. Tabela në vijim e prezanton numrin e dëmeve NN i cili fatkeqësisht ka shkuar në rritje që nga fillimi dhe ende është në shifra shqetësuese.

DËMET NN	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dëmeve të paraqitura	76	109	158	137	146	132	146
Numri i dëmeve të paguara	72	60	78	59	80	58	58
Shuma e paguar	224,370	208,793	279,821	116,956	210,676	281,746	179,988

d) Dëmet nga makineritë bujqësore traktorët, motoçikletat dhe multikultivatoret

Makineritë bujqësore të cilët kryesisht shfrytëzojnë Trafikun për punë dhe nevoja bujqësore shpesh shkaktojnë edhe dëme në Trafik me pasoja të konsiderueshme në njerëz dhe dëme materiale. Ndonëse makineritë bujqësore Traktorët janë të obliguar të sigurohen, pronaret e tyre në 99% të rasteve nuk e përmbushin këtë obligim ligjor dhe dalin në trafik pa u siguruar. Motoçikletat të cilat gjithashtu e shtojnë në numër të konsiderueshëm numrin e dëmeve të cilat Fondi i Kompensimit duhet ti paguaj, gjithashtu nuk e përmbushin obligimin ligjor për tu siguruar dhe fatkeqësisht gjatë shfrytëzimit të Trafikut shkaktojnë edhe dëme me pasoja të konsiderueshme. Në vijim tabela i prezanton numrin e dëmeve të kategorizuar nga makineritë bujqësore dhe motoçikletat.

DËMET NË VEJURA E KAMION	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dëmeve të paraqitura	1799	1901	1946	2054	1685	1642	1590
Numri i dëmeve të paguara	1765	1542	1644	1891	1496	1148	1224
Shuma e paguar	2,366,433	2,293,726	2,535,565	2,865,005	2,131,110	2,546,765	2,665,388





e) Dëmet e shkaktuara nga veturat, autobusët, kamionët (të gjitha kategoritë përveç kategorisë nën b,c,d)




DËMET NË VETURA E KAMION	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dameve te paraqitura	1799	1901	1946	2054	1685	1642	1590
Numri i dameve te paguara	1765	1542	1644	1891	1496	1148	1224
Shuma e paguar	2,366,433	2,293,726	2,535,565	2,865,005	2,131,110	2,546,765	2,665,388

f) Në tabelën dhe grafiket e mëposhtme mund të shihet pjesëmarrja e kategorive të dëmeve të paraqitura në totalin e dëmeve në Fondin e Kompensimit.

- Me tabela të Republikës së Serbisë
- Me tabela të Republikës së Malit të Zi
- Dëmet me traktorë e motoçikleta
- Dëmet me vetura e kamionë (të gjitha kategoritë e mjeteve tjera)

VITET	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
ME TABELA - SERBI	139	218	86	99	32	22	3
ME TABELA - MALI I ZI	49	49	18	16	3	9	4
DËMET - NN	76	109	158	137	146	132	146
DËMET ME TRAKTOR E MOTOÇIKLETA	246	287	357	341	314	323	356
DËMET ME VETURA E KAMION	1799	1901	1946	2054	1685	1642	1590
TOTAL:	2309	2564	2565	2647	2180	2128	2099





9. Efekti i kostos së Dëmeve të Fondit të Kompensimit - BKS në zhvillimin e Industrisë së Sigurimeve.

Bazuar në statistikat e prezantuara me sipër mund të konstatohet së Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit nga fillimi i funksionimit të tij në vite është zhvilluar dhe është financuar prej Kompanive të Sigurimeve. Trendi i rritjes së automjeteve të cilat nuk regjistrohen dhe nuk sigurohen aktualisht ka arritur në shifër shqetësuese. Numri i madh i automjeteve të cilat nuk regjistrohen dhe nuk sigurohen fillimisht e ul kapacitetin financiar të portofolios së sigurimit TPL (auto përgjegjësisë) d.m.th. Kompanitë realizojnë prim shumë më pak, janë të obliguar ligjërisht të bartin rrezik në mënyrë të padrejtë t'i mbulojnë dëmet nga këto automjete pronarët e të cilëve shkelin ligjin mbi Sigurinë në Trafik, duke mos përfillur obligimin ligjor që të dalin në trafik me automjete të regjistruara dhe të siguruara.

Në bazë të kalkulimeve të pjesëmarrjes së dëmeve në prim tek policat e rregullta del se numri i dëmeve nga automjetet e pasiguruara na jep një shifër që i afrohen 30,000 automjeteve të cilat qarkullojnë në rrugët e Kosovës të cilat nuk janë as të regjistruara edhe as të siguruara. Nga ky numër i automjeteve të pasiguruara Industria e Sigurimeve fillimisht i humb mbi 4.5 milion euro prim nga i cili prim një pjesë do të përfitonte buxheti i Republikës së Kosovës por edhe institucionet tjera nga shërbimet të cilat ky numër i automjeteve do të duhej t'i kryente për t'i regjistruar këto automjete. Nëse i shtohen edhe humbjet për dëme që së bashku me rezervat arrin në 13 milion euro në Fondin e Kompensimit atëherë vijmë te rezultati që Industria e Sigurimeve bartë rrezik pa realizuar prim në shumën afërsisht 20 milion euro në vit.

10. Infrastruktura ligjore në Republikën e Kosovës lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve

Regjistrimi i automjeteve në Kosovë bëhet në Qendrat për Regjistrim të Automjeteve në kuadër të ARC-së të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Automjetet në pronësi të personave fizik regjistrohen në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit të pronarit. Ndërsa automjetet në pronësi të personave juridik regjistrohen në bazë të certifikatës së biznesit.

Procedura e regjistrimit të automjeteve në Republikën e Kosovës bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2009 – MPB për Regjistrimin e Automjeteve, të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

11. Praktikrat ligjore të vendeve të zhvilluara aplikimi i të cilave ka rezultuar me zvogëlimin e numrit të automjeteve të pasiguruara

a). Organizimi i aktivitetit intensiv lobues në zvogëlimin-ndalimin e numrit të automjeteve të pasiguruara.

Koordinimi me Ministrinë Punëve të Brendshme lidhur me automjetet e pasiguruara – ndërtimi i një strategjie të përbashkët për zvogëlimin e veturave të pasiguruara duke marr si model vendet e BE-së.

Si modele që kanë zbatuar metoda praktike mund të marrim për shembull modelin Zvicëran, Kroat si dhe atë Gjerman.

Në Zvicër Kompania e Sigurimit në mënyrë automatike e vazhdon sigurimin e veturës. Në raste të mospagimit të premisë së sigurimit nga pala edhe pas dy vërejtjeve, Policia duhet t'ia konfiskoj tabelat. Në të kundërtën dëmin që do ta shkaktoj ky automjet do të ngarkohet dhe paguhet nga policia e kantoneve, e jo Fondi Garantues.

Ndërsa Kroacia në vitin 2008 çështjen e mos regjistrimit të automjeteve e ka rregulluar me ligj, duke caktuar afat kohor prej 7 ditëve pronarit të automjetit të cilit i ka kaluar regjistrimi që të vazhdoj regjistrimin apo të inicioj procedurën e ç'lajmërimit duke i dorëzuar targat e automjetit. Pas kalimit të afatit 7 ditor, për pronarët e automjeteve të cilët nuk e kanë vazhduar regjistrimin e veturave ose nuk e kanë çregjistruar atëherë institucionet relevante iu dorëzojnë gjobën në lartësi të konsiderueshme për mosveprim në përmbushje të ligjit.

Ndërsa modeli Gjerman çështjen e mos regjistrimit të automjeteve dhe përgjegjësit lidhur me mos regjistrimin e tyre në rast shkaktimi të aksidenteve pas paralajmërimit nga Kompania Siguruese për skadimin e policës siguruese apo anulimit të saj, organi për regjistrimit e mjeteve ka më së shumti 1 muaj afat për largimin e automjetit nga qarkullimi dhe konfiskimin e tabelave.

b). Propozimet e Fondit të Garancisë për masat të cilat do të ndikonin në zvogëlimin e numrit të automjeteve të pasiguruara në Kosovë.

1. Të intensifikohen përpjekjet e industrisë së sigurimeve që së bashku me policinë e Kosovës të gjejnë modalitetet për marrjen e masave të nevojshme me qëllim uljen e numrit të automjeteve të pasiguruara.

2. Të bëhet fushatë sensibilizuese nëpërmjet mediave vizive dhe atyre të shkruara për vetëdijesimin e shoferëve lidhur me rrezikun e mos regjistrimit të automjeteve në kuptim të regresimit të shumave nga ana e tyre në rastet kur ata janë shkaktar aksidentesh

3. Të kërkohet ndihmë nga autoritetet kompetente duke ua paraqitur faktet lidhur me pengesat e performancës së mirë financiare të industrisë për shkak të numrit të madh të automjeteve të pa regjistruara dhe siguruara.

4. Të insistohet tek organet kompetente që barra financiare të mos i takoj vetëm Fondit të Kompensimit por edhe autoriteteve në rast të mosveprimit dhe vazhdimet të kësaj praktike të lejimit të qarkullimit të këtij numri tejet të madh të automjeteve të pa regjistruara.

5. Të ju argumentohet humbja financiare në kuptim të taksave dhe përfitimit shtetëror financiar nga ulja e numrit të automjeteve të pa regjistruara dhe të pa siguruara.